

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Nebojsa Boriçiq, kryetar, Erdogan Haxhibeqiri dhe Muhamet Rexha, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Qefsere Berisha, procesmbajtës, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit Rr. B. i G. H. 'B.' nga P., kundër të paditurit – Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit, duke vendosur lidhur me kërkesën e paditësit kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.nr.335/2016 dt.24.01.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me 08.06.2017, mori këtë

### **A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa e paditësit për rishqyrtim të jashtëzakonshëm, paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.nr.335/2016 të datës 24.01.2017.

### **A r s y e t i m**

Me aktvendimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.nr.335/2016 të datës 24.01.2017, është refuzuar ankesa e paditësit paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për çështje administrative A.nr.2227/2015 dt.29.08.2016, me të cilin është hedhur poshtë padia e paditësit, si e pasafatshme, me numër A 2227/2015 dt.28.06.2016

Kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.nr.335/2016 dt.24.01.2017, paditësi ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurave, me propozim që ta aprovohet kërkesa, të anulohet aktvendimi i goditur dhe çështja të kthehet në Gjykatën e Apelit për rivendosje.

Gjykata Supreme e Kosovës, shqyrtoi shkresat e lëndës dhe pas vlerësimit të aktvendimit të goditur në pajtim me nenin 53 të Ligjit për konfliktin administrativ (LKA), ka gjetur se:

Kërkesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.nr.335/2016 dt.24.01.2017 është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit (KPK), paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për çështje administrative A.(U) nr.2227/2015 dt.29.08.2016, me të cilin është hedhur poshtë padia e paditësit si e pasafatshme, me numër A 2227/2015 dt.28.06.2016

Gjykata Supreme e Kosovës, duke e shqyrtuar kërkesën e paditësit gjen se gjykata e shkallës së dytë ka bërë aplikimin e drejtë duke e refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit dhe duke e vërtetuar

aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë me të cilin është hedhur poshtë si e pasafatshme ankesa e paditësit.

Me dispoziten e nenit 49.2 të LKA-së parashihet afati i paraqitjes së ankesës kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë, brenda 15 ditëve nga data e pranimit të vendimit. Sipas fletëkthesës për dorëzim personal, e cila gjendet në shkresat e lëndës, vërtetohet se i padituri (KPK), aktgjykimin në fjalë e ka pranuar me datën 13.07.2016, pa vërejtje, gjër sa i padituri ankesën kundër këtij aktgjykimi e ka ushtruar me datë 02.08.2016, pra jashtë afatit të caktuar ligjor. Kolegji i kësaj Gjykate vlerëson se edhe dorëzimi i parashtresave të tjera si vendimeve dhe ftesave gjyqësore, të paditurit iu janë dorëzuar në adresë të njejtë, dhe ku dërgasat janë pranuar pa vërejtje. Janë të pabazuara pretendimet ankimore se janë bërë shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, se me këtë është shkelur neni 107.1 i LPK-së. Sipas nenit 104.1 të LPK-së, i cili rregullon dërgimin e shkresave organeve shtetërore dhe personave juridik, përcaktohet se dërgimi bëhet duke i dorëzuar shkresat personit të autorizuar për pranimin e tyre, apo të punësuarit që gjenden në zyrë ose në lokalin e punës. Nga interpretimi i drejtë i kësaj dispozite ligjore, kjo Gjykatë vlerëson se dorëzimi është kryer në rregull.

Nga kjo gjendje e vërtetuar, Gjykata Supreme e Kosovës gjen se gjykata e shkallës së dytë ka bërë aplikimin e drejtë të dispozitave ligjore në fuqi, duke e refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit, dhe duke e vërtetuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë me të cilin është hedhur poshtë si e pasafatshme padia e paditësit.

Poashtu, Gjykata Supreme vlerëson se janë të pabazuara thëniet e paditësit lidhur me shkeljet, ngase vendimi i goditur është i qartë dhe i kuptueshëm. Arsyetimi i aktvendimit të goditur përmbanë arsye të mjaftueshme dhe faktet vendimtare për marrjen e vendimeve të ligjshme. Po ashtu, kjo Gjykatë vlerëson se është bërë aplikimi i drejtë të drejtës materiale.

Nga sa u tha më lartë dhe në pajtim me nenin 54.1 të LKA-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË**

ARJ.UZVP nr.33 /2017 dt. 08.06.2017.

Procesmbajtësi,  
Qefsere Berisha

Kryetari i kolegjit,

Nebojsa Boriçiq

Përktheu: Ferid Abazi